REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJEOGRAFISË

Programi: **Bachelor**

Lënda: GJEOGRAFI E SHQIPËRISË (PJESA E I-RË)

Pedagogu:	Dr. Arben BELBA
Ngarkesa:	4 ETCS (2 leksione dhe 1 seminar në javë)
Lloji i lëndës:	e detyrueshme
Programi i studimit:	Bachelor, Gjeografi
Viti/semestri:	II/II

Shkurtesë: Gjeografia e Shqipërisë (Pjesa e I-rë) është një nga lëndët kryesore që ndikon në formimin gjeografik dhe atdhetar të studentëve. Ajo përfshihet në trungun fizik të gjeografisë. Objektivi kryesor i saj është përcjellja tek studentët e lidhjeve dhe bashkëveprimit të ndërsjelltë midis përbërësve fiziko-gjeografik të mjedisit natyror të vendit.

Gjeografia e Shqipërisë trajton çështje të rëndësishme si: roli i pozitës gjeografike në zhvillimin social ekonomik të Shqipërisë; ndërtimi gjeologjik i Albanideve, shumëllojshmëria e shkëmbinjve dhe strukturave, evolucioni morfotektonik të tyre dhe pasuritë e nëntokës; komplekset gjenetike të relievit dhe shtrirja gjeografike e tyre, që me larminë e theksuar të formave janë atraktive për turistët nëpër territorin e RSH-së; klima mesdhetare, tiparet, shumëllojshmëria, pasuria klimatike dhe ndikimin i saj në zhvillimin e proceseve gjeografike natyrore e humane, por edhe në zhvillimin ekonomik dhe përcaktimin e sezoneve turistike pothuajse gjatë gjithë vitit; pasuritë ujore, tokat, flora dhe fauna e pasur dhe e shumëllojshme, si elemente të rëndësishëm të mjedisit gjeografik shqiptar, drejtimet e shfrytëzimit, problemet e lindura nga ndërhyrjet në këtë mjedis, duke pikësynuar në shfrytëzimin racional sot dhe në perspektivë të këtyre pasurive. Kategoritë e zonave të mbrojtura trajtohen si pjesë e trashëgimisë natyrore dhe me vlera turistike. Pasuritë natyrore trajtohen si premisë zhvillimi social ekonomik dhe turistik të vendit.

Temat e leksioneve:

1. Hyrje: Objekti, detyrat e metodat e studimit të Gjeografisë fizike, lidhja e ndërsjelltë e saj me shkencat e tjera të afërta.

2. Pozita gjeografike dhe ndikimi i saj në dukuritë gjeografike me karakter natyror e human.

3. Ndërtimi gjeologjik i Albanideve, shumëllojshmëria e shkëmbinjve, strukturave dhe evolucioni morfotektonik i tyre.

3. Komplekset gjenetike të relievit, shtrirja gjeografike e tyre dhe roli i larmisë së madhe së formave të relievit në krijimin e peizazheve interesante dhe diverse.

4. Karakteristikat e përgjithshme dhe rajonizimi fiziko-gjeografik, kriteret e këtij rajonizimi dhë rëndësia praktike e tij.

5. Klima mesdhetare, tiparet, shumëllojshmëria dhe ndikimin i saj në zhvillimin e proceseve gjeografike natyrore e humane. Roli i pasurive klimatike dhe dukurive negative në zhvillimin human.

6. Tiparet e hidrografisë, rezervat ujore, shkalla e shfrytëzimit dhe e ndotjet së tyre.

7. Tokat, bimësia dhe fauna, si elemente të rëndësishëm të mjedisit gjeografik shqiptar dhe premisa për zhvillimin e llojeve të veçanta të turizmit

Veçoritë fiziko-gjeografike të Krahinës Veriore dhe pjesëve përbërëse të saj.

8. Rajonizimi fiziko-gjeografik i Krahinës Qendrore, nën njësitë përbërëse të saj.

9. Pjesa veriore e Krahinës Qendrore dhe veçoritë e ndërtimit gjeologjik të relievit, klimës, hidrografisë, të tokave dhe bimësisë.

10. Pjesa jugore e Krahinës Qendrore dhe ndryshimet fiziko-gjeografike të saj prej asaj Veriore.

11. Faktorët dhe kushtet e rajonizimit të Krahinës Jogore, nënnjësitë përbërëse të saj dhe veçoritë dalluese ndërmjet tyre.

12. Pjesa VL e Krahinës Jugore me veçoritë e ndërtimit gjeologjik, të relievit, klimës, hidrografisë, të tokave, të florës dhe faunës së saj.

13. Pjesa JP e Krahinës Jugore me tiparet dalluese të ndërtimit gjeologjik, tipareve të relievit, të klimës, hidrografisë, të tokave, mbulesës floristike e faunistike të saj.

14. Veçoritë fiziko-gjeografike të Ultësirës Perëndimore dhe nënnjësive përbërëse të saj.

15. Shndërrimet antropogjene në mjedisin fiziko-gjeografik të vendit, problemet e lindura prej tyre dhe rrugët për shfrytëzimin racional sot e në perspektivë.

Forma e kontrollit dhe vlerësimit

- *Detyrim frekuentimi në*: 70% të seminareve

- *Angazhimi në seminare:* 10% e notës

- *Detyra e kursit*: *Përpilimi i profilit gjeomorfologjik mbi bazën e atij gjeologjik* 20% e notës

- *Kontrolli përfundimtar:* provim me shkrim 70% e notës

- Gjithsej: 100%

Literatura bazë:

1. Aliaj SH., *Neotektonika e Shqipërisë*, Tiranë 2012.

2. Grup autorësh., *Gjeografia fizike e Shqipërisë*, Akademia e Shkencavee R.P.SH, Qendra e Studimeve Gjeografike, Tiranë 1990.

3. Instituti i studimeve dhe projektimeve gjeologo-minerale. Harta gjeologjike e Shqipërisë, Tiranë 1990.

4. Instituti i studimeve gjeologo-minerale**.,** Harta tektonike e Shqipërisë, Tiranë 1990.

5. Instituti i Hidrometeorologjisë., Klima e Shqipërisë, Tiranë 1975.

6. Instituti i Hidrometeorologjisë., Atlasi klimatik i Shqipërisë, Tiranë 1990.

7. Instituti i Hidrometeorologjisë., Hidrologjia e Shqipërisë, Tiranë 1985.

8. Instituti i Studimit të Tokave., Harta e tokave të Shqipërisë, Tiranë 1985

9. Qendra e Studimeve Biologjike, Flora e Shqipërisë, Tiranë 1992.